


WUS Austria vazhdon ta mbësh




Atifete BELA

WUS Austria edhe gjatë vitit 2010 ka vazhduar mbështetjen e Arsimit të Lartë në Kosovë duke realizuar një numër të konsiderueshëm të projekteve që kanë për synim ngritjen e cilësisë së studimeve në Kosovë. Kjo mbështetje i ndihmon Universitetit të Prishtinës në përmbushjen e reformave në përputhshmëri me Konventën e Lisbonës dhe Procesin e Bolonjës. Gjatë këtij viti WUS Austria ka implementuar një sërë projekteve në fusha të ndryshme, përfshirë projekte përsigurim të cilësisë, reformim dhe zhvillim të programeve mësimore, si dhe u ka mundësuar profesorëve nga Kosova të emigruar jashtë vendit të mbajnë ligjëratë në UP.

But Dedaj, Drejtor Rajonal i Zyrës së WUS Austria në Prishtinë, deklaron se vetëm gjatë këtij viti në kuadër të Programit për Kthimin e Trurit janë realizuar dhjetëra vizita nga profesorë nga Kosova që punojnë ne universitete të Evropës dhe të Amerikës. "Programi për Kthimin e Trurit (BGP+) synon sjelljen e profesorëve, asistentëve ose ekspertëve të fushave të ndryshme që kanë studiuar jashtë dhe vazhdojnë të punojnë dhe jetojnë atje, duke i ftuar ata për të ligjëruar si mysafirë, të marrin pjesë në punë kërkimore dhe zhvillimore dhe të janë mentorë të tezave të studentëve në Universitetin e Prishtinës. Vetëm në periudhën shkurt - qershori kemi realizuar dhjetë vizita studimore, ndërsa aktualisht kemi dy profesorë me periudhë të zgjatur kohore - prej një semestri - që janë në implementim e sipër. Ndërsa, deri në fund të vitit priten të realizohen



Itesë Arsimin e Lartë në Kosovë



edhe një numër i konsiderueshëm i vizitave", ka treguar Dedaj.

Sipas tij, rëndësi i kushtohet edhe reformimit të programeve mësimore në UP, ku nëpërmjet Programit për Zhvillim të Kurrikulave (CDP+) janë modifikuar metodologjikisht apo janë futur si lëndë të reja rrëth 21 sosh. Veç kësaj, profesorët që kanë qenë bartës të këtyre lëndëve janë ndihmuar edhe me blerje të pajisjeve të nevojshme për mbarëvajtjen e lëndës: "Ky program inkurajon fakultetet të prezantojnë lëndë të reja mësimore dhe të aplikojnë qasje inovative në përbajtje dhe metodologji. Nga viti 2008 deri më 2011 kanë përfunduar me sukses së implementuar 21 lëndë nga fakultete të ndryshme të Universitetit të Prishtinës.

Përpos projekteve të finançuara nga shteti dhe Qeveria Austriake, WUS Austria implementon edhe projekte të finançuara nga Komisioni Evropian nëpërmjet programit TEMPUS. Qëllimi kryesor i këtyre projekteve është integrimi i Kosovës në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, që kanë si fokus Sigurimin e Cilësisë dhe nxitjen e Punës Kërkimore në Universitetin e Prishtinës. Projekti TEMPUS për "Krijimin e Kapaciteteve të Hulumtimit dhe Zhvillimit dhe Instrumenteve për nxitjen e Bashkëpunimit në mes të Arsimit të Lartë dhe Ekonomisë" si objektiv kryesor ka të kontribuojë në krijimin e kapaciteteve dhe instrumenteve të punës kërkimore dhe zhvillimore në përputhje me objektivat e Programit TEMPUS dhe prioriteteve të Arsimit të Lartë dhe Shoqërisë. "Universiteti i Prishtinës do të marrë mbështetje intensive, duke e ndihmuar atë në krijimin e kapaciteteve dhe instrumenteve të Punës Kërkimore dhe zhvillim të cilat ofrojnë përfitime afatgjata", potencon Dedaj. Gjithashtu, WUS Austria në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës dhe tri universitete evropiane kanë filluar zbatimin e projektit tjetër TEMPUS "Qendra Ndërsidiplinore e Trekëndëshit të Dipes e Kosovës – Arsimi i bazuar në Studimet e Dok-

toratës, Hulumtimit dhe Trajnimit për Shkencat Mjekësore dhe Natyrore", që ka synim përmirësimin e kushteve për zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese profesionale dhe studimore në programet e doktoraturës për shkenca mjekësore dhe natyrore në Universitetin e Prishtinës (UP). Në kuadër të këtij projekti parashitet të hapet një Qendër e Trekëndëshit të Dipes, e cila do të jetë si një laborator modern, i cili do të shërbente si platformë për punë shkencore dhe komunikim me botën akademike. Përpos bashkëpunimit me Universitetin e Prishtinës, WUS Austria në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Agjencinë e Akreditimit të Kosovës dhe disa universitete evropiane kanë filluar ta implementojnë projektin për "Mbështetjen dhe Zhvillimin e strukturave për sigurimin e cilësisë në bartësit privatë të arsimit të lartë në Kosovë". But Dedaj cilëson tepër të rëndësishëm këtë projekt, pasi përfitues të këtij projekti janë dhjetë institucione private të Arsimit të Lartë. "Qëllimi kryesor i këtij projekti është themelimi apo përmirësimi i mekanizmave dhe instrumenteve për sigurimin e cilësisë në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë në përputhje me objektivat e Strategjisë për Zhvillimin e Arsimit të Lartë në Kosovë 2005-2015 dhe Parimet e Bolonjës të Bashkimit Evropian", thotë Dedaj.

WUS Austria u themelua në vitin 1983 si një komitet kombëtar i OJQ-së ndërkombëtare World University Service (WUS), dhe që nga atëherë ka mbështetur rindërtimin dhe procesin e reformimit në fushën e Arsimit të Lartë me një fokus rajonal në Evropën Juglindore. Me qendër në Graz, WUS Austria ka edhe zyrat rjonale në Prishtinë, Sarajevë, Beograd dhe Podgoricë. Duke reaguar ndaj një thirrje për mbështetje nga Universiteti i Prishtinës (Sistemi Paralel Shqiptar), WUS Austria ka themeluar zyrën e saj në Prishtinë në tetor të vitit 1998. Qysmë atëherë WUS Austria dhe shteti austriak janë mbështetës të tjerë mëdhenj të Arsimit të Lartë në Kosovë. ■